



Rr. "Komuna e Parisit" Nr. 4
Po. Box. 7435
Tirane, Shqiperi.
Tel. / fax 00355 / 4/ 321389
Dt. 11/07/2008

Nr. 29 Prot.

D E N O N C I M,

**Drejtoria e Pergjithshme e Policise Ndertimore,
z. Hekuran Hoxhalli**

I nderuar z. Drejtor,

Me dt. 25.06.2007, Komuna Farke ne mbeshtetje nga Policia Ndertimore Tirana Rreth, pa nje urdher ekzekutimi, filloi ne menyre te menjehershme dhe te kundraligjshme prishjen e portes kryesore te Misionit Shenjteror Eleonore, te ambientit ku strehoheshin njerezit e braktisur dhe zaptoi rreth 3.000 m² truall te Misionit, nga te cilat rreth 800 m² jane prone legitime e Misionit Shenjteror Eleonore, regjistruar ne ZRPP, me nr. pasurie 109/103 dhe pjesa tjeter eshte ne proces legalizimi. Kostoja e demit material te shkaktuar eshte rreth 10 milion leke te reja. Cenimi u krye me pretendimin se aty do te ndertoheshin rruge dytesore 13 ml te gjera, per pallatet te cilat jane ndertuar rreth Truallit ku ushtron aktivitetin Misioni yne.

Jemi vetem dy jave qe nga koha e kryerjes se kesaj masakre ne Truallin tone dhe shohim se trualli i cili iu morr padrejtesisht Misionit jo vetem qe nuk po perdoret per ndertimin e rruges, por perkundrazi po perdoret nga firma I&L shpk, per zmadhimin e pallatit ekzistent dhe per ndertimin e nje tjeter pallati.

Kjo firme jo vetem ka hapur gropen e pallatit brenda territorit te planifikuar per rruge, por njekohesisht sot ka filluar punen per prishjen e pilotave te cilat sherbenin si baze mbrojtese per ndalimin e rreshkitjeve masive te dheut. Kryerja e ketyre punimeve